
AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
KG Tech Solutions

Sot, me date 09 Janar 2024 në Rr. Zonja Çurre Nd.2 H.1 Ap.1 Njësia Administrative nr. 2 Tiranë, Shqipëri është prezent presoni fizik, Z. Andi Gurabardhi, lindur më datë 11.02.1998 në Tiranë, dhe rezident në Tiranë në adresën e mësipërme, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 033008410 dhe numër personal J80211047B, e lëshuar më datë 25.01.2016 dhe e vlefshme deri më datë 24.01.2026, Personi si më sipër i cilësuar dhe i përfaqësuar ka deklaruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, themelimin e një shoqërie në bazë të ligjit n. 9901 del 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe si pasojë edhe redaktimin e Aktit të Themelimit të saj aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga statuti i saj, pjesë plotësuese e këtij akti themelimi të aprovuar dhe rregulisht të nënshkruar nga ana e ortakëve si më poshtë vijon:

NENI 1

Themelohet shoqëria tregtare kapitali e tipit me përgjegjësi të kufizuar emëruar **KG Tech Solutions Sh.p.k.**, më poshtë e quajtur edhe shoqëria.

Shoqëria është objekt i ligjit shqiptar, ndërsa filialet që mund të krijohen do të jenë objekt i ligjit të vendit ku ato do të kenë selinë.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të këtij akti themelimi dhe në bazë të Statutit të saj të miratuar nga ortakët.

NENI 2

Selia e shoqërisë është në Rr. Zonja Çurre, Nd.2, H.1, Ap.1, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë Shqipëri.

NENI 3

Objekti i shoqërisë do të jetë si më poshtë:

Zhvillimi i Software, konsulencë IT dhe shërbime të tjera IT. Zhvillimin e softwerë-ve të avancuar, duke ofruar zgjidhje inovative përmes zbatimit të programimit të ekspertëve. Ofrimi i zgjidhjeve softwerike të përshtatura sipas nevojave të klientëve.



Prodhim dhe asistencë teknike të software-ve për makineri për zyra dhe për laboratorë elektronikë dhe sisteme të telekomunikimit dhe të produkteve që lidhen me to;

Implementim, zhvillim, realizim, instalim, mirëmbajtje dhe menaxhim të software-ve, rrjeteve të telekomunikimit etj.

Shoqëria mund të marrë ose të japë detyra agjencie, urdhëra, mandate, si dhe gjithashtu të kryej të gjitha veprimet tregtare, financiare, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund, gjithashtu, të jetë pjesëmarrëse ose të ketë pjesë në shoqëri të tjera ose ndërmarrje të çfarëdo lloji natyre që kanë objekt analog, të përafërt ose të lidhur me objektin e vet. Mundet gjithashtu të lëshojë garanci të veçanta dhe garanci në përgjithësi edhe reale por me kushtin që të jenë të lidhura me objektin e shoqërisë.

NENI 4

Për zhvillimin e aktivitetit të saj, shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizik dhe juridik, të vendit ose të huaj.

NENI 5

Shoqëria, ka një kohëzgjatje pa afat dhe do të marrë personalitet në momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë që i përkasin ortakëve të renditur si më poshtë:

Ortaku Themelues: Z. Andi Gurabardhi, qytetar shqiptar lindur më datë 11.02.1998 në Tiranë, dhe rezident në Tiranë në adresën Rr. Zonja Çurre Nd.2 H.1 Ap.1, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, Shqipëri madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 033008410 dhe numër personal J80211047B, e lëshuar më datë 25.01.2016 dhe e vlefshme deri më datë 24.01.2026, i cili do të zotërojë 1 (një) kuotë me një vlerë totale prej Lekë 10.000 (dhjetëmijë) e cila do të përbëjë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose mund të rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar.

NENI 7

Ortakët e shoqërisë marrin përgjegjësin për të rritur volumin e punëve në shoqëri, të respektojnë detyrimet për sa i përket ruajtjes së sekretit që janë të lidhura me tipin e aktivitetit tregtar që do të zhvillohet nga shoqëria dhe të mos dëmtojnë interesat e vetë shoqërisë në mënyra të ndryshme.

NENI 8

Administratori i shoqërisë do të jetë Znj. Ariana Gurabardhi, qytetare shqiptare, lindur më 16.03.1973 në Tiranë Shqipëri, dhe rezident në Tiranë, në adresën Rr. Zonja Çurre Nd.2 H.1 Ap.1 Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 033187873 dhe numër personal H353160561, e lëshuar më datë 18.08.2016 dhe e vlefshme deri më datë 17.08.2026, e cila emërohet për 5 (pesë) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtën për t'u rizgjedhur.

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit vendosen në statut.

NENI 9

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Asambleja e përgjithshme vendos në bazë të ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.

NENI 10

Asambleja e përgjithshme emëron ose revokon Administratorët që janë në detyrë dhe mund të emëroje dhe administratorë të tjerë duke i shtuar atyre ekzistues dhe me kompetenca të përcaktuara në bazë të ligjit.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligji, për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, do të përfaqësoje shoqërinë në raportet me të tretët me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti i jep ortakëve shprehimisht.

Kompetencat e administratorit janë vendosur në Statutin e Shoqërisë, në bazë të ligjit.

Për çështje të një rëndësie të vecantë, administratori konsultohet me ortakët dhe aplikon vendimet e asamblesë së ortakëve, të marra me shumicën e parashikuar nga ligji.

NENI 11

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve do të zgjidhen në bazë të nenit 30 të Statutit të Shoqërisë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të përgjithshme, e realizuar sipas dispozitive ligjore në fuqi dhe mund të ketë edhe një markë të vetën.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e themeluar në aplikim të plotë të normave të Statutit dhe në bazë të normave ligjore shqiptare dhe në veçanti me ligjin n. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Akti i themelimit hartohet në 3 (tre) kopje të nënshkruara rregullisht nga ortakët.

Tiranë, më 09 Janar 2024

**KG Tech Solutions
Ortaku
Andi Gurabardhi**

